

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, departamenti për krime të rënda**, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Agim Ademi – kryetar i trupit dhe gjyqtarëve Ramiz Azizi dhe Afrim Shala anëtar të trupit, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarit Q. A., nga f. Gj. Komuna e V., të cilin me autorizim e mbron avokat H. A., nga Gj., për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PP. nr. 100/2016 e datës 09.06.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datë 18.10.2016, bie dhe në prezence të palëve me datë 20.10.2016 publikisht shpalli këtë:

## AKTGJYKIM

### **I akuzuari:**

I akuzuari Q. A., nga babai K. dhe nena M., e lindur H., i lindur me date ..., në fshatin Gj. Komuna e V. ku edhe jeton, ... martuar, baba ... fëmije, i punësuar në biznesin e tij privat "...” me seli në fshatin Gj., ka të kryer ..., i gjendjes se ... ekonomike Shqiptar Shtetas i Republikës se Kosovës.

## ËSHTË FAJTOR

### **I.**

Se me datë ... .2016, rreth orës ..., në fshatin Gj. Komuna e V., i akuzuari me veprim të drejtpërdrejtë ka tentuar ta privoj nga jeta tani të dëmtuarin B. R., në atë mënyrë që fillimisht pas një mosmarrëveshje paraprake para lokalit të tij "...” i njëjti fillimisht nga brezi ka nxjerr një revole të markës "...” të kalibrit... mm, duke shtënë në ajër ... herë e më pas kthehet në shtëpi, ndërsa të dëmtuarit largohen nga vendi i ngjarjes, mirëpo pas pak kohe prap të dëmtuarit në vendin e ngjarjes kthehen me veturën e markës "...” duke e parë këtë gjendje i akuzuari me armën e markës ... ka shtënë ... herë në ajër e më pas në drejtim të veturës ku ishin të dëmtuarit, me ç rast me predha goditet vetura ku ishin B. R. dhe B. R., në derën e pasme të anës së majtë duke depërtuar predha brenda dhe goditur të dëmtuarin B. R., në anën e djathtë të belit si dhe duke depërtuar më tej dhe goditur edhe në krahun e djathtë, dhe nga shkrepija e armës ... i dëmtuari B. R. pëson lëndime të lehta trupore në anën e djathtë të belit dhe në dorën e djathtë, me këto veprime i akuzuari ka tentuar ta privoj nga jeta të dëmtuarin.

Me çka ka kryer veprën penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-ës.

## II.

Me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin nën I. të aktgjykimit i akuzuari pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në pronësi armët e zjarrit dhe atë një ... me gaz e markës “...” e kalibrit ... mm, me numër serik ..., ... karikatorë dhe ... plumba të kalibrit ... mm, si dhe një pushkë automatike e markës ... pa numër serik, ... karikatorë me ... plumba të kalibrit ... mm, në atë mënyrë që gjatë bastisjes nga pjesëtarët policor armët e lartë cekura janë sekuestruar.

Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës.

Andaj, Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7, 17, 21, 41, 45, 69,73,75, 76, 83, 114 të KPRK-ës, dhe neneve 365, 453, të KPPRK-ës.

## E G J Y K O N

**Të akuzuarin Q. A.**, për veprën penale nën dispozitivin I. të aktgjykimit i shqiptohet dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 (tre) viteve, dhe për veprën penale nën dispozitivin II, me dënim burgu në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve e me dënim unik burgu në kohëzgjatje prej **3 vjet e 2 muaj (tre vjet e dy muaj) burgim**, të cilin dënim burgu i akuzuari do ta vuaj 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në dënimin e shqiptuar do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim **26.04.2016 e deri me datë 20.10.2016.**

Të akuzuarit i është shqiptuar edhe dënimi plotësues konfiskimi i armëve të sekuestruara edhe atë arma me gaz e tipit “...” si dhe pushka automatike e markës ..., ... karikator dhe ... plumba ... mm ... dhe ... karikator dhe ... plumba ... mm ... .

Obligohet i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **Arsyetim**

*Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krimeve të Rënda ka ngritur aktakuzë PP. nr.100/2016 e datës 09.06.2016, kundër të akuzuarit Q. A. nga fsh.Gj. Komuna e V., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 paragrafi 1 nen para.1.11 lidhur me nenin 28 të KPRK-ës, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe të dënohet me dënim merititor sipas ligjit.*

**Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda Arben Ismajli**, fillimisht mbeti në tërësi pranë aktakuzës ndërsa në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar deklaroi se i akuzuari Q. A. e ka pranuar veprën penale nën dispozitivit II, të aktit akuzues. Sa i përket dispozitivit I, është vërtetuar se i njëjti e ka kryer edhe këtë vepër penale, e kjo nga dëshmia e të dëmtareve B. R. dhe B. R. të cilët kanë deklaruar se natën kritike me të akuzuarin kanë pasur një mosmarrëveshje lidhur me parkingun dhe duke qenë se në largim e sipër nga vendi i ngjarjes kanë dëgjuar disa krismash armësh e më pas janë kthyer të njëjtit përsëri në vendin e ngjarjes dhe pas bisedës që kanë pasur, kanë hyrë në veturë dhe pasi që janë nisur kanë dëgjuar të shtëna me armë po ashtu që një predhë fillimisht ka goditur në shpinë të dëmtuarin B. R. deri sa plumbi më pas i ka depërtuar edhe në krahun e djathtë. Gjendja faktike është vërtetuar edhe nga deklarata e dëshmitarëve A. A. i cili po ashtu ka deklaruar se ka pasur një mosmarrëveshje lidhur me parkingun e veturës së A. dhe se para lokalit të Q. më pas ishin kthyer të dëmtuarit me veturën e tipit "...", me ç' rast i dëmtuari B. R. e kishte pyetur se kush ka gjuajtur me armë derisa B. ka shkuar tek shkallët e lokalit me që rast edhe kishte filluar mosmarrëveshje dhe shtyrja ndërmjet tyre e që më pas Q. nga oborri i tij prej 3- 4 metra, i kishte thënë B. dhe B. që të largohen derisa në dorë ka mbajtur një armë të tipit kallashnikovë ..., me që rast i ka dëgjuar edhe dy të shtëna dhe më pas B. dhe B. me vrull me veturë janë larguar nga vendi i ngjarjes dhe është dëgjuar edhe një e shtënë me armë edhe dëshmitari A. A. nuk e mohon se kishte qenë një mosmarrëveshje para lokalit të Q. dhe ishin dëgjuar të shtëna armësh pasi që janë nisur B. i dhe B. me veturë dhe më pas të njëjtit ishin kthyer përsëri në vendin e ngjarjes dhe pas një bisede Q. ju kishte thënë që të largoheshin dhe kishte dëgjuar një të shtënë. Kjo gjendje faktike vërtetohet edhe me dëshminë e dëshmitarit A. I. i cili deklaroi se pasi që e kishte lënë veturën para lokalit të Q., A. e kishte takuar duke e larguar veturën e tij. Po ashtu edhe dëshmitari N. K. nga Njësia e Forenzikës ka deklaruar se në vend të ngjarjes janë gjetur 5-6 gëzhoja të armës me gaz si dhe 3 gëzhoja të armës automatike, si dhe gjurmë shpuese në veturë në anën e majtë të derës së prapme dhe ka depërtuar edhe në ulësen e vozitësit duke depërtuar në trupin e të dëmtuarit.

*Gjendja faktike vërtetohet edhe me provat materiale dhe atë foto dokumentacioni, raporti i forenzikës me të cilat vërtetohet trajektorja e predhës e cila ka depërtuar nga dera e majtë e prapme nga lartë – poshtë.*

*Se i dëmtuari B. R. ka pësuar lëndime trupore vërtetohet edhe nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko ligjor . Edhe i akuzuari Q. A. ka pohuar se ka pasur një mosmarrëveshje dhe ka shtënë me armë me gaz si dhe ka pohuar se nga shtëpia e tij ka marr armën ..., nga oborri i tij*

ka kërkuar që të largohen të dëmtuarit dhe nga një distancë 3-5 metra ka shtënë me armë në drejtim të tokës dhe se armën një familjar ia ka larguar nga dora.

Mbi bazën e provave të administruara i propozojmë gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj me dënim meritot për veprat penale të cilat i vihen në barrë në mënyrë që dënimi i shqiptuar të jetë në proporcion me peshën e veprave penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprave .

**I dëmtuari B. R.**, deklaroi se nuk i bashkohem ndjekjes penale ndaj të akuzuarit sikundër edhe nuk ushtroi kërkesë pasuroro –juridike njëherë familjarisht jemi pajtuar. I dëmtuari B. R. në cilësinë e dëshmitarit shtoi: se në ditën kritike rreth orës ..., kam shkuar me veturën e djalit të axhës të tipit “...” tek lokali i Q. derisa në lokal brenda ka qenë djali i axhës tim B. dhe A., pasi që paraprakisht i kisha ftuar për të pirë kafe në fshatin B.. I kam marrë me veturë dhe kemi shkuar për të pirë kafe në K. dhe para lokalit të Q. ka qenë i parkuar automjeti i A. i llojit “ ... me ngjyrë të ...”. Pasi kemi Q. për gjysmë ore në K. jemi kthyer përsëri tek lokali i Q. për ta marrë veturën e A.. Me të arritur para lokalit kemi vërejtur se vetura nuk ishte në vendin ku e kishte lënë A. por që e njëjta ishte në mes të rrugës dhe duke larguar veturën ishin tre persona njëri prej tyre A1 deri sa dy personat e tjerë nuk i ka njohur. E kam ndalur veturën dhe nga vetura kemi dal unë, A. dhe B. për të biseduar se pse ishte larguar vetura- kombi i A.. E di që se njëri prej atyre personave ka deklaruar se “ e largoj dhe sma ndien”, ngase e keni parkuar para shtëpisë sime. Distanca në mes B., A. dhe atyre personave që kane qenë duke e larguar veturën ka qenë 1.5 metra. Nga vetura – kombi i A. më pas kanë dalur ata persona dhe ka hypur A. për ta marr veturën, por a ka pas fyerje në mes tyre nuk e di pasi që unë isha duke e kthyer veturën time. Pas 15 minutash fillimisht nga vendi i ngjarjes është larguar A. me veturë – kombi, deri sa më pas me veturë me mua ka ardhur edhe B. dhe jemi nisur nga vendi ngjarjes dhe pasi kemi ecur rreth 10 metra kam dëgjuar krismë por nuk e kam ditur se kush ka shtënë por kjo ka ardhur nga shtëpia e Q. . Me atë rast unë jam kthyer prapa ( rikferc) para lokalit të Q. dhe aty kanë qenë A1 dhe dy persona tjerë, deri sa Q. nuk e kamë pa para lokalit. Kemi dalur nga vetura dhe e kemi pyetur A1 se kush ka shtënë deri sa A1 vetëm ka thënë “ ec, ec” dhe komunikonte me telefon, deri sa personat tjerë nuk kanë pasur asgjë në dorë. Pas 5 minutash unë dhe B. me veturë jemi nisur për në shtëpi dhe pas rreth 3 metrave që ishim nisur kam dëgjuar të shtëna por sa të shtëna kanë qenë nuk e di dhe më pas jam qëlluar me plumb në pjesën e shpinës dhe më pas plumbi ka depërtuar edhe në dorën e djathtë të cilën e kisha në ndërruesin e shpejtësisë, se kush ka shtënë nuk e di por e shtëna ka ardhur nga lokali i Q. , automjeti është goditur me 4 predha edhe atë një në rezervar, tjetri në derën e prapme të anës së majtë dhe dy të tjerë nëpër veturë. Me rastin e goditjes me predhë me mua në veturë ka qenë edhe B. ulur në ulësen e përparme dhe si pasojë e të shtënave ka mundur të na vrasë të dyve por unë jam mirë fatmirësisht dhe distanca prej nga është shtënë ka qenë rreth 5 metra.

**B. R. në deklaratën e cilësisë së të dëmtuarit** në Prokurorinë Themelore në Gjilan deklaroi se nuk i bashkohem ndjekjes penale ndaj të akuzuarit sikundër edhe nuk ushtroi kërkesë pasurore –juridike njëherë familjarisht jemi pajtuar deri sa i dëmtuari në cilësinë e dëshmitarit në deklaratën e dhënë në prokurori kishte theksuar: se në ditën kritike së bashku me A. I. rreth orës ... min, kemi shkuar në lokalin e Q. A. i cili është në shtëpinë e tij, e i cili

është lokal i lojërave . Në atë lokal me A. kemi luajtur lojëra play station dhe kemi qëndruar deri rreth orës ... min, dhe pasi kishim dalur me A.n për një gjysmë ore nga lokali jemi kthyer përsëri në lokal dhe kemi vazhduar me lojëra. Deri sa ishëm duke luajtur më ka thirrur B. R. djali i axhës tim dhe së bashku me A.n dhe B. in kemi shkuar në K. për të pirë kafe dhe në atë lokal kemi qëndruar rreth një ore. Më pas jemi kthyer për ta marrë veturën e A.t të markës “...” të cilën A. e kishte lënë para lokalit të Q. . Në momentin kur kemi arritur para lokalit të Q. , veturën e A.t e kishte ndezur Q. dhe A1 për ta larguar nga vendi ku e kishte lënë A. me të vërejtur A. ka zbritur nga vetura e B. it dhe ju ka thënë Q. dhe A1t pse e keni ndezur veturën. Q. iu ka përgjigjur se nuk mundë ta lë veturën përpara shtëpisë time. Pas kësaj bisede A. ka hipur në veturën e tij dhe është larguar nga vendi i ngjarjes, derisa B. i e ka kthyer veturën dhe është nisur me vrull “shllajf”, dhe më pas është dëgjuar një krismë e armës dhe në ato momente B. i e ka ndalur veturën dhe është kthyer për të biseduar me A1n, A. dhe M. dhe njëkohësisht janë fjalosur, ashtu që duke hyre ne veture unë me B. in, Q. ka dale nga shtëpia ka bërë titur “se pse po e shllajfitni” dhe ka shtënë me ... dy here në drejtimin të B. it, deri sa ka tentuar të gjuaj në drejtim timin por M. ja ka larguar .... Më pas ne kemi hipur ne veture dhe jemi nisur ne drejtim te shtëpive dhe përsëri është dëgjuar krisma e armës ..., pas pak çaste B. i me njoftoj se ishte plagosur. Ka ndalur veturën dhe unë kam dalë për ta drejtuar automjetin dhe për ta dërguar B. in tek mjeku. Paraprakisht nuk kemi pasur ndonjë mosmarrëveshje me Q. .

**Dëshmitari N. K. deklaroj se:** Natën kritike më datë ... .2016 rreth orës ... min pas mesnate jemi njoftuar nga operative se ka ndodhur një rast i vrasjes në tentative ne fshatin Gj. të Komunës së V.. Ne atë rast kemi shkuar se bashku me F. R. nga krim teknika dhe në vend të ngjarjes kanë dalë edhe oficerët B. K. dhe R. B., në Spitalin Regjional në Gjilan kemi takuar shoqëruesin e të dëmtuarit A. I. dhe kemi marrë një xhakete në të cilën është vërejtur se kishte depërtuar një predhë. Në vend ngjarje në hyrje të fshatit e kemi kontaktuar të dyshuarin Q. A.n te shitorja “...”, i cili ka pranuar se kishte shtënë me armë, se fillimisht kishte shtënë me ... me gaz e më pastaj edhe me armë automatike të tipit ....Na ka treguar edhe vendin se ku e kishte lënë armën ... në dhomën e ndenjës, derisa ... ishte ne katin e tretë të shtëpisë. Ne vend ngjarje kemi gjetur 5-6 gëzhoja të armës me gaz dhe sa më kujtohet 3 gëzhoja të armës automatike.

Gjurma shpuese në veturë ka qenë te dorëza e derës së prapme të anës së majtë dhe e njëjta ka depërtuar brena në veturë duke e goditur ulësen e vozitësit dhe ka shkuar në drejtim të frenit të dorës. Pas një kohe përsëri kemi shkuar në vendin e ngjarjes por kubëzat e dëmtuara para lokalit nuk kemi arritur të i vërtetojmë se janë si pasojë e shkrepses së armës. Kemi bërë edhe shikimin e veturës e cila ka qenë e përfshirë në rast dhe nën rezervarin e veturës është vërejtur një vrimë por nuk kam mundur të konstatoj se është nga predha.

**Dëshmitari A. A. deklaroj se :** Mbrëmjen kritike më datë ...2016 kam qenë në shtëpi dhe kah ora ..., kam shkuar në lokalin e Q. të cilin e kam djallë të axhës dhe në atë lokal një pjesë e ka shitore dhe një pjesë tjetër e shfrytëzon për internet, për lojëra të ndryshme. Me të hyrë në lokal kam vërejtur se aty ishin Q. A1 dhe një kushëri i yni M., B. R. dhe A. I.. Para lokalit kam vërejtur veturën- ... e A.. Në lokal kam qëndruar rreth një apo një ore e gjysmë dhe deri sa unë kisha vendosur dëgjueset duke luajtur me kompjuter dhe përgatitësim për ta mbyllur lokalin, A1 dhe Q. e kishin larguar në trotuar veturën e A.t, A1 më ka treguar se kishin

pasur një mosmarrëveshje me A.n dhe se A. e ka marr veturën dhe ka ecur. Pasi që A1 dhe Q. kanë hyrë në lokal, B. i dhe B. me veturën e tipit “...” janë nisur me vrull duke i dhënë gaz. Q. ka shtënë një-dy herë me revole me gaz , ashtu që pasi janë nisur B. i dhe B. të njëjtit janë kthyer prapa “rikferc” dhe janë ndalur para lokalit të Q. dhe që të dy kanë zbritur nga vetura deri B. i është drejtuar me fjalët “ kush gjuajti”, unë i’u kam përgjigjur “hajt se nuk është bërë asgjë”. Deri sa isha duke i qetësuar B. in edhe B.n, B. i është afruar tek shkallët e lokalit duke i thënë A1t se “ kur unë gjuaj, gjuaj ndryshe”. Ka filluar shtyrja në mes dy palëve, pastaj kanë filluar edhe sharjet. Nga oborri ka ardhur Q. i cili ishte larg nga neni 3-4 metra dhe ka bërëtitur duke i thënë B. it dhe B.t largohuni nga këtu dhe e ka mbajtur në dorë një armë ..., dhe kam dëgjuar dy të shtëna. Më pas B. i dhe B. kanë hipur në veturë dhe janë nisur vrullshëm duke sharë dhe përsëri kanë dëgjuar një të shtënë përpjetë. Dua të shtoj se në ato momente Q. ka qenë në gjendje jo të mirë emocionale.

**Dëshmitari A. A. deklaroj se :** në ditën kritike më datë ....2016 rreth orës ... kam shkuar tek lokali i Q. për t’ia rregulluar kompjuterët. Në ndërkohë kanë ardhur A. dhe B.n me veturën e tipit “...”, dhe pasi që kanë qëndruar në lokal për një kohë në telefon e ka ftuar B. in dhe unë kisha dëgjuar për këtë ngase B. i ka thënë A.t se po na thërret B. i për kafe. Më pas ka ardhur B. i dhe i ka marr A.n dhe B.n me veturën e tij, derisa vetura e A.t ka mbetur para lokalit të Q. . Rreth orës ... deri sa unë dhe Q. ishim duke e larguar veturën e A.t, janë kthyer me veturë B. i, B. dhe A.. Derisa veturën e A.t e kishim larguar rreth 20 metra dhe vetura ishte e ndezur por duke e shtyer, A. e ka pyetur Q. n se pse po e largoni veturën, e Q. është përgjigjur se nuk më keni pyetur dhe po e mbyll lokalin. Nga vetura e B. it kishin zbritur që të tre dhe pasi që mosmarrëveshja kishte zgjatur 2-3 minuta, A. ka hyrë në veturën e tij dhe ka vazhduar rrugën, deri sa unë isha duke shkuar në lokal e pas meje vinte Q. ashtu që B. dhe B. i kanë hyrë në veturë janë kthyer para lokalit duke i dhënë “shllajf”, atëherë unë kam dëgjuar një krismë të shkrepur nga Q. e më pas B. i dhe B. janë kthyer prapa (rikferc) dhe në ato momente unë kam dalë tek dera e lokalit. B. i e ka hapur xhamin e veturës dhe ka pyetur “kush gjuajti” e më pas ka dalë jashtë, unë iu kam përgjigjur “ ec o kush se nuk u bë asgjë”. Më pas doli nga vetura edhe B. duke qëndruar prapa B.. Q. nuk e di se ku ka qenë por po supozoj se ishte në oborr, e më pas ja kam dëgjuar zërin nga drejtimi i oborrit duke thënë “apo largoheni nga këtu”, pastaj kam dëgjuar të shtëna në drejtim të kubëzave dhe më pas është dëgjuar edhe zhurma e veturës, e më pas krismën. Pas shkrepjes së armës Q. ka qenë në gjendje depresive dhe jo të mirë.

**Dëshmitari A. I. deklaroj se :** në mbrëmjen kritike kemi shkuar tek lokali i Q. së bashku me B. R. me veturën e babait tim të tipit “...”, dikun rreth orës ..., aty kemi qëndruar deri kah ora .... Deri sa ishim duke qëndruar në lokal, B.n e ka ftuar B. R. i cili më pas ka ardhur me veturën e tij të tipit “...” dhe së bashku me B.n kemi shkuar me veturën e B. it në K. tek restorant “...”, ku kemi qëndruar rreth 30 minuta. Nga aty jemi kthyer përsëri tek lokali i Q. dhe kur kemi shkuar aty veturën e time e kishin zhvendosur nga vendi ku e kam lënë afër 200 metra në drejtim të trafos. Vetura ime kishte qenë e ndezur dhe në veturë ishte A1 derisa afër veturës ishte Q. me atë rast unë iu kam thënë të dyve se nuk është dashtë ta lëvizur veturës dhe se për këtë punë janë Policia, Q. është përgjigjur se vetura jote më ka penguar dhe unë i kam kërkuar falje. Nga vetura kanë zbritur edhe B. i me B.n, por të njëjtit nuk janë afruar te vetura ime dhe as nuk kanë folur me A1 dhe Q. . Me veturë nga aty jam nisur unë së pari e më pas me veturën e B. janë

*nisur B. dhe B.. Nga aty unë me veturë kam shkuar në shtëpinë time dhe unë me atë rast nuk kam dëgjuar krisma. Pasi kam shkuar në shtëpi dhe e kisha lënë një takim me një nip timin dhe isha duke e pritur atë para shtëpisë ka arritur B. dhe B. dhe në atë rast B. më tha eja hyr në veturë se e kanë plagosur B., dhe më tha se e ka plagosur Q. . Unë fillimisht nuk i besova por kur e kam prekur B. kam vërejtur se kishte gjakderdhje, ashtu që fillimisht jemi nisur për në V. për ndihmë mjekësore, më pas me veturë të Ambulancës kemi shkuar në Emergjencën e Spitalit të Gjilanit. Se çfarë i kanë pasur raportet mes veti më parë nuk e di, por B. më ka thënë se e gjithë kjo ka ardhur për shkak të një “shllajfi” që e kishte bërë B. para lokalit të Q. .*

***I akuzuari Q. A. në mbrojtjen e tij deklaroi se :*** *natën kritike rreth orës ... – ... në lokalin tim në të cilin e kam një market dhe një pjesë të ndarë për video lojëra, ka ardhur B. dhe A. edhe disa persona tjerë për të luajtur. B. dhe A. kanë ardhur me një veturë të tipit “...”, ata kanë qëndruar deri në ora ... e më pas jashtë lokalit ka ardhë një veturë tjetër dhe ka fishkëlluar e unë kam dalë e ai personi më tha “thirrma B.”, më pas B. edhe A. pasi që ju thash që po ju thërret dikush jashtë kanë dalë nga lokali dhe kanë shkuar.*

*Dikun rreth orës ... derisa isha duke mbyllur lokalin e kam vërejtur veturën e A. të parkuar para shitore dhe në atë rast i kam thënë djalit të axhës tim A1 që të më ndihmojë që ta largojë veturën për shkaqe sigurie. Vetura ka qenë e hapur dhe çelësat ishin në të, e kam ndezur veturën por pasi që nuk kam arritur ta fus në rikferc, i kam thënë A1 “hyn ti mbaje timonin dhe unë po të shtyj”. Kështu nga vendi ku ka qenë e parkuar vetura të njëjtin e kemi larguar afro 15 metra. Në ato momente me një veturë tjetër erdhën A., B. dhe B. ashtu që të njëjtit kanë dalë nga vetura dhe A. ka fillua të bërtas duke përdorur edhe fjalë të rënda “ se a e dini e kujt është vetura, dhe a e din se të mbys”, jam përgjigjur se “largohu nga këtu e mos bon probleme”, dhe ashtu duke u shtyrë A. ka hyrë në veturën e tij dhe është nisur në drejtim të fshatit kanë hyrë edhe B. i me B.. Derisa unë isha duke shkuar tek lokali me A1, B. i është nisur në drejtim tonin me veturë vrullshëm, unë nga frika kam shtënë me revole me gaz 5-6 herë. Jam kthyer në shitore i frikësuar dhe njëri nga djemtë e axhës tim më kanë thënë se u kthyen përsëri me veturë B. dhe B.. I shqetësuar kam shkuar në shtëpi dhe kam marr armën automatike ... dhe kam zbritur në oborr dhe kam dëgjuar duke u fjalosur B. dhe A1, unë ju kam bërtitur B. dhe B. largohuni nga këtu dhe kam shtënë me armë automatike në ajër, por të njëjtit nuk janë larguar unë përsëri kam bërtitur që të largohen, në ato momente kam drejtuar pushkën në drejtim të tokës me qëllim që ti frikësoj të njëjtit kam shtënë 2-3 herë në drejtim të tokës e më pas pushkën nga dora ma ka kapur dikush dhe ma ka larguar, pastaj të njëjtit kanë hipur në veturë dhe kanë shkuar. Se a kamë shtënë me pushkë pasi që të njëjtit kanë filluar të largohen nuk më kujtohet, pasi që janë larguar B. dhe B. djali i axhës tim e ka mbyllur lokalin ndërsa unë kam shkuar në shtëpi dhe në ato momente jam ndjerë i plogështuar dhe ashtu kam vepruar nga frika ndërsa me dashje nuk do të kisha vepruar kurrë. Vetura e B. it ka qene e parkuar ne atë pozicion që pjesa e pasme e veturës ka qenë kah oborri i shtëpisë, po ashtu dua të shtoj se unë revolen me gaz e kam mbajtur rregullisht për shkak se kam pasur shitore dhe të mbrohem nga vjedhjet, derisa armën automatike e kemi pasur në shtëpi moti kohë. Me të dëmtuarit nuk kemi pasur mosmarrëveshje dhe as fjalosje.*

**Mbrojtësi i të akuzuarit Q. A., avokat H. A.,** në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar e të elaboruar në seancën gjyqësorë shtoi : Nga provat e lustruara nuk është vërtetuar teza e akuzës se i akuzuari Q. ta ketë kryer veprën penale vrasje e rëndë në tentativë, pasi që nuk janë plotësuar një mori kriteresh për ekzistimin e rrethanave veçanërisht të rënda ngase në rastin konkret duhet të ekzistojë një shkallë e larte e kundërligjshmërisë, pasi në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me vrasjen e dy e më shumë personave por kemi të bëjmë me një person me lëndime të lehta trupore bëhet fjale për të dëmtuarin B. R., derisa i dëmtuari B. R. nuk ka marrë kurrfarë lëndime. Në rastin konkret tek i akuzuari mungon elementi i dashjes dhe po të kishte qëllim vrasjen i akuzuari do të kishte shtënë në drejtim të tyre duke pas parasysh distancën e vogël prej 5-6 metra nga të dëmtuarit. Se i akuzuari nuk ka pasur për qëllim shkaktimin e pasojës, shihet nga fakti se i njëjti fillimisht ka shtënë në ajër e më pas në tokë, pra qëllimi në rastin konkret ka qenë që i akuzuari të i frikësoj të dëmtuarit që të njëjtit të largoheshin nga vendi ku gjendeshin para lokalit përkatësisht shtëpisë së tij. Pra duke qenë në presion psikik pas fyerjeve të rënda dhe i kanosur nga rreziku nga përlëshjet ka vepruar në rastin konkret duke mos pasur mundësi që ta mënjanoj rrezikun në ndonjë mënyrë tjetër. Nga rrethanat e rastit konsiderojmë se nuk përmbushen elementet e veprës penale sikurse në aktakuzë por tiparet e veprës penale nga neni 188 lëndim i lehtë trupor të KPRK-së të kryer me armë apo mjet të rrezikshëm, duke qenë se i dëmtuari ka marrë lëndime të natyrës së lehtë trupore duke qenë i provokuar nga sjellja e vrazhde dhe jo njerëzore e dëshmitarit A. I. dhe të dëmtuarëve. Po që se nuk përmbushen elementet veprë penale lëndim i lehtë trupor, atëherë ekziston vepra penale nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, ngase nuk ekzistojnë rrethana posaçërisht rënduese. Duke qenë i sjellë në presion psikik pas fyerjeve që i ka bërë dëshmitari A. drejtuar të akuzuarit si dhe A1 dhe A. A., i njëjti i sjellë në gjendje të përgjegjësisë së zvogëluar i njëjti është shtyrë ta kryejë këtë vepër duke mos pasur qëllim, se po të ekzistonte qëllimi i njëjti do të kishte varrë.

Me rastin e matjes së dënimit duhet të merren parasysh rrethana lehtësuese të cilat ekzistojnë se i akuzuari dhe i dëmtuari janë pajtuar, i dëmtuari nuk i bashkangjitet ndjekjes penale, se nuk ushtron kërkesë pasurore juridike, se më parë nuk ka qenë i gjykuar, se pendohet thellë për atë çka i ka ndodhur, se premtonte që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, është njeri familjar, se është i martuar dhe baba i një fëmije, andaj konsiderojmë që edhe me një dënim më të butë do të arrihet qëllimi i dënimit.

**I akuzuari Q. A., në fjalën përfundimtare deklaroi:** se e përkrahu në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim avokatit H. A., pendohem thellë për atë që ka ndodhur, edhe një herë i kërkoi falje të dëmtuarit, me të dëmtuarit jemi pajtuar, premtoi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, andaj kërkoi nga Gjykata që të më shqiptohet një dënim sa më i butë që është e mundur.

Gjykata bëri shtjellimin dhe analizimin e provave materiale edhe atë: Vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve më datë 06.04.2016, raporti mjekësor numër 9161/16 i datës 26.04.2016, fletë lëshimi nga data 26.04.2016 deri më 05.05.2016 lëshuar nga Spitali Regjional në Gjiilan, mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko ligjor me numër të referencës 102 lidhur me natyrën e lëndimeve trupore të pësuar nga i dëmtuari B. R., foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes dhe atë 23 foto, si dhe leximin e deklaratave të të dëmtuarit B. R. të dhëna



ne Stacionin Policor më datë 28.04.2016 dhe në Prokurorinë Themelore në Gjilan më datë 12.05.2016.

Pas shtjellimit dhe analizimit të gjitha provave veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 dhe 361 të KPPRK gjykata konstatoi këtë gjendje faktike: se ditën kritike më datë 26.04.2016 në lokalin "...", ... , pronë e të akuzuarit Q. A. në fshatin Gj. Komuna e V., i dëmtuari B. R. si kundër edhe dëshmitari A. I. kishin shkuar për të luajtur lojëra kompjuterike rreth orës ... me veturën e dëshmitarit A. të tipit "...", me ngjyrë ..., të cilën e kishin parkuar para lokalit të Q. . Pasi që kishin qëndruar një periudhë kohore, B. e kishte ftuar me telefon B. R. (djali i axhës së tij ), për të shkuar për kafe në një vend tjetër. Pasi që B. i me veturën e tij të tipit "... ngjyrë të bardhë kishte ardhur para lokalit të Q. dhe i kishte sinjalizuar B. që të dal nga lokali. B. së bashku me A. kishin dalë nga lokali dhe me veturën e B. kishin shkuar për të pirë kafe në K. në restorant "...", deri sa veturën e A. e kishte lënë para lokalit të Q. . Pasi që kishin qëndruar rreth një ore në restorant, të dëmtuarit B. R., B. R. dhe dëshmitari A. I., me veturën e B. it ishin kthyer tek lokali i te akuzuarit Q. për ta marrë veturën e A.. Me te arritur para lokalit të Q. , kishin vërejtur se vetura e A. nuk ishte ne vendin ku e kishin parkuar, por që të njëjtën ishin duke e lëvizur A1 dhe Q. ashtu që vetura ishte e ndezur e të cilin ishte duke e drejtuar A1 derisa Q. ishte duke e shtyer nga pas dhe se vetura ishte e zhvendosur rreth 20 metra. Me të parë se veturën ishin duke e lëvizur Q. dhe A1 i dëmtuari B. kishte ndalur veturën e tij dhe nga vetura ka dalë A. dhe iu kishte drejtuar me fjalët " se pse e keni lëvizur veturën sepse për këtë punë është Policia", më pas nga vetura kanë dalë edhe të dëmtuarit B. dhe B. R. të cilët kanë qëndruar afër veturës së tyre, deri sa A. ishte fjalosur me të akuzuarin Q. dhe me A1, derisa vetura e tyre ishte larg rreth 1.5 deri në 2 metra. Pas fjalosjes së shkurtër nga vetura e A. ka zbritur A1 dhe ne veture ka hyre A. dhe është nisur ne drejtim të shtëpisë së tij. Më pas ne veturën e tyre kanë hyrë edhe B. me B., e kanë kthyer veturën dhe janë nisur vullshëm derisa A1 dhe Q. janë nisur në drejtim të lokalit, e në ato qaste Q. ka nxjerrë revolen me gaz dhe ka shtënë 5-6 herë në ajër. Pasi që B. i dhe B. ishin larguar rreth 10 metra me veturë dhe e kanë dëgjuar krismën nga revolja, janë kthyer dhe janë afruar me veturë para lokalit të Q. . Në ato momente para lokalit ishte A1 dhe A2, deri sa të dëmtuarit B. R. dhe B. R. kanë dalë nga vetura, B. i është ofruar dhe e ka pyetur A1n "kush gjuajti". A1 iu ka përgjigjur "hajt se nuk është bërë kurgjo". Më pas ka filluar fjalosja mes tyre dhe në ato momente Q. kishte hyrë në shtëpi ka marrë armën automatike të tipit ... dhe nga oborri i shtëpisë në një distancë prej 5-6 metra ka bërë titur "largohuni nga këtu", dhe ka shtënë me armë në ajër 2-3 herë me ndërprerje. Pasi që të dëmtuarit ishin larguar dhe kanë hyrë në veturën dhe ishin nisur , në drejtim të veturës ka shtënë përsëri i akuzuari nga arma automatike me që rast një predhë ka goditur derën e pasme të anës së majtë në pjesën e dorëzës, ashtu që predha ka depërtuar në brendësi, ka goditur mbështetësen e ulëses së vozitësit ku ishte i ulur i dëmtuari B. R. duke depërtuar në anën e djathtë të belit duke depërtuar më tej në drejtim të ndërruesit të shpejtësive dhe e ka goditur edhe krahun e djathtë të të dëmtuarit B. . Më pas armën automatike të akuzuarit Q. ia ka marrë nga dora personi i quajtur me emrin M.. Më pas me veturën e tipit "... janë larguar i dëmtuari B. si dhe B. R. në atë mënyrë që pasi ishte i goditur me predhë i dëmtuari B. veturën e ka drejtuar B. dhe pasi që janë nisur në drejtim të V. në rrugë e kanë takuar tani dëshmitarin A. I. dhe e kanë dërguar për trajtim mjekësor të dëmtuar B. në shtëpinë e shëndetit në V., e pas marrjes së ndihmës së parë i dëmtuari dërgohet për trajtim mjekësor në

Spitalin Regional në Gjilan. Si pasojë e predhës së shkrepur i dëmtuari B. R. ka pësuar lëndime të lehta trupore të përshkruara si në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko ligjor me numër të referencës 102.

Me rastin e konstatimit të gjendjes faktike gjykata ia fal besimi provave materiale edhe atë: mendimit dhe konstatimit të ekspertit mjeko ligjor me numër të referencës 102 lidhur me atë se në cilat pjesë të trupit i dëmtuari është goditur nga predha si dhe për faktin se këto lëndime të pësuar cilësohen si lëndime të natyrës së lehtë trupore. Po ashtu në cilësi të provës materiale iu ka besu edhe shikimit të foto dokumentacionit dhe atë lidhur me faktin se vetura është goditur në derën e pasme të anës së majtë në pjesën e dorëzës dhe trajektorja që e ka marrur predha me rastin e goditjes, vërtetimit mbi sekuestrimin e armëve të datës ....2016 në të cilin shihet se janë konfiskuar pushka automatike e tipit ..., revole R. kalibri ..., ... karikator me ... plumba të revoles, ... karikator dhe ... plumba të pushkës automatike ..., iu fal besimi dëshmisë së dëshmitari N. K. lidhur me faktin se para shitore së të akuzuarit është goditur me predhë vetura e të dëmtuarit B. në derën e pasme të anës së majtë, e cila predhë ishte shkrepur nga ana e armës automatike duke depërtuar në brendi dhe duke goditur mbështetësen e ulëses së vozitësit dhe duke goditur të dëmtuarin në anën e djathtë të belit dhe në dorën e djathtë, si dhe për faktin se në vend ngjarje janë gjetur 5-6 gëzhoja të revoles R. dhe 3 gëzhoja të armës automatike, si dhe për faktin se në rezervarin e veturës është vërejtur një vrimë por që nuk është konstatuar se ishte shkaktuar nga predha. Pjesërisht iu fal besimi dëshmime të dëshmitarëve A. A. dhe A. A. për faktin se ditën kritike në lokalit e Q. me veturën e A. kishin ardhur B. R. dhe A. I., se pas një kohe të njëjtit i kishte marrur i dëmtuari B. me veturën e tij duke e lënë veturën e A. para lokalit, për faktin se veturën e A. e kishin larguar nga aty A1 dhe Q. si dhe për faktin se fillimisht pas fjalosjes tek vetura e A., Q. kishte shtënë me revole me gaz e më pas pasi që në rikfrec ishin kthyer B. dhe B. me veturë dhe përsëri B. ishte fjalosur me të njëjtit, Q. kishte shtënë me armë automatike nga oborri në ajër, por nuk iu fal besimi pjesës se deklaratës se tyre kur deklarojnë se pasi B. dhe B. kishin hyrë në veturë. Q. kishte shtënë në atë drejtim të tokës, ngase kjo pjesë e deklaratës bie ndesh me prova materiale edhe atë foto dokumentacioni lidhur me trajektoren e predhës, ngase po të goditej në tokë predha do të merrte një trajektore tjetër duke shkuar nga poshtë lartë, e jo siç shihet në foto në një trajektore horizontale përkatësisht në mënyrë të pjerrët nga lartë poshtë. Po ashtu iu fal besimi dëshmisë së dëshmitari A. I. lidhur me faktin se në ditën kritike së bashku me B.n kanë qëndruar në lokalit e Q. duke parkuar veturën para lokalit të tij e që më pas kishin shkuar nga aty me një lokal tjetër duke e lënë veturën para lokalit të Q. , e që më pas pasi që janë kthyer e kishin takuar A1n dhe Q. duke e larguar veturën e tij, dhe ishte fjalosur me të njëjtit. Gjykata pjesërisht ia fal besimin dëshmisë së të dëmtuarit të dhënë në cilësi të dëshmitarit B. R. lidhur me faktin se ditën kritike i njëjti me veturën e tipit "...", fillimisht nga lokali i Q. i kishte marrë B. dhe A., se vetura e A. kishte ngelur e parkuar para lokalit të Q. , me tu kthyer përsëri për ta marrur veturën e A., kishin hasur në Q. n dhe A1 duke larguar veturën, se A. ishte fjalosur për faktin sepse ia kishin larguar veturën dhe më pas pasi që A. ishte larguar me veturë dhe B. me B. in e kishin kthyer veturën e tyre kishin dëgjuar të shtëna dhe më pas ishin kthyer para lokalit për tu u sqaruar se kush kishte shtënë, e po ashtu edhe faktin se deri sa ishin para lokalit kishin dëgjuar të shtëna, e edhe pasi që kishin hyrë në veturë dhe ishin nisur kishin dëgjuar të shtëna dhe ishte goditur, por nuk ju fal besimi deklaratës së tij kur deklaroi se vetura të cilën ishte duke e

voztur ishte qëlluar me katër plumba nga se ko pjesë e deklaratës bie ndesh me provat tjera si raporti nga vendi i ngjarjes si dhe dëshmia e dëshmitarit N. K.. Po ashtu iu fal besimi dëshmisë së të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit B. R., për faktin se kishin shkuar me A. tek lokali i Q. , më pas B. i kishte ardhur dhe e kishte marrur, për faktin se vetura e A. kishte mbetur e parkuar para lokalit të Q. , se kur ishin kthyer për ta marrë veturën, veturën ishte duke e larguar A1 dhe Q. se A. ishte fjalosur për faktin se vetura ishte larguar dhe te njëjtit pasi që ishin nisur me veturë kishin dëgjuar krisma, ishin kthyer përsëri para lokalit të Q. me B., se Q. kishte shtënë me armë automatike, se pasi që ishin kthyer me veturë dhe ishin nisur ishte dëgjuar krisma ku B. i i kishte thënë që është plagosur. Pjesërisht ia fali besimin edhe mbrojtjes së të akuzuarit Q. A. lidhur me faktin se në lokalit e tij kishin ardhur fillimisht B. me A. me veturë te A.t, se më pas aty kishte ardhë B. R. duke i marrë të njëjtit, se para lokalit të tij kishte mbetur vetura e A.t dhe se ai e A1 e kishin larguar veturën e A.t, se A. ishte fjalosur me të njëjtit për atë që ishte lëvizur vetura, fillimisht kishte shtënë nga revolja me gaz, për faktin se nga shtëpia kishte marrë pushkën automatike ..., dhe fillimisht kishte shtënë në ajër 2-3 herë por nuk iu fal besimi mbrojtjes së tij se më pas kishte shtënë në drejtim të tokës për ti frikësuar të dëmtuarit dhe se kjo pjesë e deklaratës bie në kundërshtim me provat tjera e ne veçanti me provën materiale – foto dokumentacioni ku në veturë shihet trajektorja e predhës të shkrepur nga i akuzuari ngase se po te ishte ashtu siç thotë i dëmtuari trajektorja e predhës do te kishte khaje krejtësisht tjetër edhe atë nga toka lartë e jo në drejtim horizontal pjerrët nga lartë poshtë, si dhe kjo pjesë e deklaratës bie në kundërshtim edhe me deklaratat e të dëmtarëve se të shtënat ishin dëgjuar edhe pasi ishin nisur me veturë. Kjo pjesë e deklaratës së të akuzuarit se nuk kishte shtënë në drejtim të veturës por që kishte shtënë në ajër konsiderojmë se është në kundërshtim me provat e tjera, është bërë përpjekje e të akuzuarit për t’iu shmangur përgjegjësisë penale.

Nuk qëndron as konstatimi i mbrojtësit të të akuzuarit nga fjala përfundimtare se i akuzuari të ketë vepruar në tronditje të thellë me veprimet e të dëmtuarve për faktin se në rastin konkret nuk kishte pasur as rrahje reciproke por vetëm fjalosje për më tepër fjalosjet në rastin konkret janë zhvilluar në mes të dëmtuarit B. R.t dhe dëshmitarit A. A..

Trupi gjykues mbi bazën e gjendjes së konstatuar faktike bëri ri cilësimin e kualifikimit juridik të veprës penale nga vepra penale e vrasjes së rëndë në tentativë nga neni 179 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, në vepër penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, për faktin se qëllimi i të akuzuarit nuk ishte që të i privonte të dy të dëmtuarit nga jeta ashtu siç e kërkon dispozita e cekur më lartë për vepër penale vrasje e rëndë ngase me rastin kur i akuzuari ka shtënë fillimisht ishte në një distancë 5-6 metra larg të dëmtuarve dhe ka pasur mundësi ta bënte një gjë të tillë, por se i njëjti në drejtim të veturës ku ishte i dëmtuari B. kishte shtënë pasi që vetura ishte nisur. Pra mbi këtë bazë dhe duke mos u vërtetuar qëllimi që i akuzuari kishte dashtë për ti privuar nga jeta dy personat, por duke shtënë në drejtim të të dëmtuarit B. , pasi që i njëjti ishte më i zëshëm me rastin e mosmarrëveshjes para lokalit derisa i dëmtuari B. gjithnjë kishte qëndruar prapa, Trupi Gjykues gjeti se në rastin konkret kemi të bëjmë me vepër penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së. Pra në rastin konkret nga të theksuarat e përmendura më lartë, trupi gjykues gjeti se fare nuk është kontestues fakti se i akuzuari Q. A. ka shtënë në drejtim të

dëmtuarit B. R. me armën e tipit ..., duke e goditur të njëjtin dhe duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore.

Se i akuzuari Q. A. ka kryer edhe veprën penale nën dispozitivin II të aktgjykimit mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së, u vërtetua me vetë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit Q. A., i cili pranim i fajësisë është mbështetur edhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lendes e në veçanti vërtetimi mbi sekuestrimin e armëve të datës 26.04.2016 në të cilin shihet se janë konfiskuar pushka automatike e tipit ..., revole R. kalibri ...mm, ... karikator me ... plumba të revoles, ... karikator dhe ... plumba të pushkës automatike ..., si dhe foto dokumentacionit.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Trupi Gjykues pati parasysh rrethanat e parapara nga neni 73 të KPRK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese ka gjetur se i akuzuari ka shprehur keqardhje të thellë për rastin që ka ndodhur duke iu kërkuar falje të dëmtuarve, se më parë i njëjti ka qenë i pa gjykuar dhe nuk ka rënë në kundërshtim me ligjin, ka premtuar se bë të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, se është i moshës relativisht të re, është njeri familjar, ... martuar dhe baba ... fëmije, se me familjen e të dëmtuarve janë pajtuar dhe se të dëmtuarit nuk janë bashkangjitur ndjekjes penale, si dhe nuk kanë ushtruar kërkesë pasurore juridike, si dhe për faktin se ngjarja ka ndodhur aty për aty duke mos pasur paraprakisht mosmarrëveshje me të njëjtit, por edhe për faktin se për veprën penale në dispozitivin II e ka pranuar fajësinë dhe vullnetarisht i ka dorëzuar armët me rastin e bastisjes si dhe faktin se të dëmtuarit i janë shkaktuar lëndime të natyrës së lehtë trupore dhe gjendja shëndetësore e të dëmtuarit është e mirë. Ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh rrezikshmërinë e veprës penale duke qenë se në rastin konkret përdorimi i armës së zjarrit nga ana e të akuzuarit, ka mundur të ketë qenë edhe me pasoja më të rënda si dhe faktin se i njëjti ka vepruar me dashje. Në prezencë rrethana më të shumta lehtësuese dhe duke u bazuar në nenin 75-76 të KPRK-së, Trupi Gjykues të akuzuarit i shqiptoj dënim nën minimumin e paraparë ligjor me bindje se edhe me një dënim si në dispozitiv të aktgjykimit do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e armëve të sekuestruara edhe atë revole me gaz e tipit “...” si dhe pushka automatike e markës ..., ... karikator dhe ... plumba ...mm ... dhe ... karikator dhe ... plumba ... mm .... është bazuar në nenin 374 paragrafi 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është i bazuar në nenin 454, të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**  
**PKR.nr.134/2016 Më datë 20.10.2016**

**Sekretarja juridike,**  
Naile Neziri d.v

**Kryetari i trupit gjykues,**  
Agim Ademi d.v

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krime të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.